



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Nr.Ref.KGJK 01 / 190

Nr.Ref.KPK 145 / 2020

E lidhur me datën 09.03.2020;

## Marrëveshje në mes të

### Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës

### Për avancimin dhe mirëmbajtjes së SMIL dhe Qendrës së të dhënave

## **Neni 1 Objekti i Marrëveshjes**

Objekt i kësaj marrëveshje, është iniciimi i procedurave të prokurimit dhe shfrytëzimi i përbashkët i kontratave.

## **Neni 2 Qëllimi i Marrëveshjes**

- 2.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i procedurës dhe rregullave të bashkëpunimit dypalësh në mënyrë që të sigurohet shfrytëzim i përbashkët i kontratave dhe ndarjen e përgjegjësisë lidhur me iniciimin procedurës dhe realizimit të kontratave.

## **Neni 3 Lloji i tenderit**

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial planifikojnë zhvillimin e procedurave në prokurim dhe shfrytëzimin e kontratave të përbashkëta për tenderin me dy lloje:

- 3.1. Lloti I: Avancimi dhe mirëmbajtja e qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë,  
3.2. Lloti II: Avancimi dhe mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) për prokurori dhe gjykata.

## **Neni 4 Përgatitja e specifikacionit teknik**

Departamenti i TI të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës janë përgjegjës për përgatitjen e specifikacionit teknik të detajuar për të dy tenderët në bashkëpunim edhe me Divizionin e Prokurimit.

## **Neni 5 Sigurimi i fondeve buxhetore**

- 5.1 Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës janë përgjegjës për sigurimin e mjeteve për tenderët e specifikuar.
- 5.2 Departamenti i TI të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës përgatisin deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve para se të bëhet iniciimi i procedurave sipas rregullave në fuqi.

**Neni 6**  
**Inicimin e procedurave**

Departamenti i TI të Këshillit Prokurorial të Kosovës është përgjegjës për inicimin e procedurave sipas ligjit të prokurimit publik.

**Neni 7**  
**Shpall e tenderit**

- 7.1 Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës autorizojnë Divizionin e Prokurimit në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përgatitjen e dosjes së tenderit, shpalljen dhe menaxhimin e tërësishëm të këtij aktiviteti.
- 7.2 Divizioni i Prokurimit (SKPK) është i obliguar të ndjek të gjitha procedurat ligjore të paraparë në ligjin e prokurimit dhe aktet tjera nënligjore.

**Neni 8**  
**Komisioni i vlerësimit**

- 8.1 Komisioni i vlerësimit do të jetë i përbashkët në mes të Departamentit të TI të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial.
- 8.2 Përbërja komisionit do të jetë nga dy anëtarë nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial si dhe një anëtar i Divizionit të Prokurimit (SKPK).

**Neni 9**  
**Menaxhimi i kontratës**

- 9.1 Në secilën kontratë do të caktohen nga dy menaxher, një për Këshillin Gjyqësor dhe një për Këshillin Prokurorial.
- 9.2 Përcaktimi i menaxhereve të kontratave bëhet me vendim nga Drejtorët e Sekretariateve të të dy Këshillave.

## **Neni 10**

### **Raport i punëve**

- 10.1 Menaxheret e kontratës, përgjegjës për menaxhimin e kontratës për Llot I: Avancimi dhe mirëmbajtja e qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë Lot I, janë të obliguar të përgatisin raport të përbashkët për menaxhimin e kontratës, i njëjti raport, dërgohet në KGJK dhe KPK për procedim të pjesës së pagesës sipas marrëveshjes.
- 10.2 Menaxheret e kontratës, përgjegjës për menaxhimin e kontratës për Llot II: Avancimi dhe mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) për prokurori dhe gjykata, janë të obliguar të përgatisin raporte të veçanta në menaxhimin e kontratës. Menaxherët respektiv, dërgojnë raportet përkatëse të menaxhimit të kontratave në KGJK dhe KPK për procedim të pagesave.
- 10.3 Për çdo pagesë janë të obliguar të përgatisin raportin për punët e realizuar i cili ju bashkëngjitet lëndës për pagesë.
- 10.4 Përgjegjësit e menaxherit të kontratës janë të përcaktuar me udhëzimin e prokurimit.

## **Neni 11**

### **Pagesat**

Pagesa për shpenzimet e krijuara sipas kontratës do të bëhet si vijon:

- 11.1 Për kontratën: Avancimi dhe mirëmbajtja e qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë,  
Çdo pagës e cila pranohet nga operatori në përputhje me kontratën e nënshkruar, shuma ndahet në përqindje.  
Kjo nënkupton që shpenzimi i bërë duhet të ndahet në dy fatura, 70% e shumës se përgjithshme të faturës procedohet për pagesë në emër të Këshillit Gjyqësor, ndërsa 30% në emër të Këshillit Prokurorial (referuar sipas marrëveshjes për shfrytëzimin e përbashkët të qendrës së të dhënave).  
Sekretariatet e Këshillave janë përgjegjëse për realizimin e pagesave, sipas procedurave dhe kritereve të parapara në kontratë dhe rregullave tjera financiare në fuqi.
- 11.2 Për kontratën: Avancimi dhe mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) pagesat për faturë do të bëhen ndaras, kjo nënkupton që sistemet gjatë avancimit dhe mirëmbajtjes do të kenë shuma të ndara të cilës i përgjigjet drejt për së drejti institucionit.

**Neni 12**  
**Mbikëqyrja e marrëveshjes**

Vënia në zbatim e kësaj marrëveshje përkatësisht zbatimi i kontratave do të mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoret e Sekretariateve të KGJK dhe KPK, dhe sipas nevojës përgatitin raport të veçanta të cilat përcjellën te menaxhmeti i KGJK dhe KPK.

**Neni 13**  
**Ekzemplarët e Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje përgatitet në 2 kopje ekzemplarë të së njëjtës përmbajtje, secila prej tyre nënshkruhet nga palët kontraktuese.

**Neni 14**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Palët nënshkruese

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

z. Skender Çoçaj

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshilli Prokurorial i Kosovës

z. Bahri Hyseni

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës

